



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**Plani i Veprimit për Implementimin e
Udhërrëfyesit të Qeverisë së Kosovës për
Liberalizimin e Vizave me Bashkimin
Evropian
(2009-2011)**

Tetor 2009
Prishtinë, Kosovë

Përmbajtja

Historiku.....	3
Synimi i Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave	5
Plani i Veprimit.....	7
1. Siguria e dokumenteve/kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit	7
2. Bashkëpunimi i agjencioneve në zbatimin e ligjit/parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, drogave dhe korrupsionit.....	9
3. Bashkëpunimi gjyqësor në fushën e çështjeve penale	16
4. Politikat e azilit.....	18
5. Menaxhimi i migrimit	19
6. Menaxhimi i kufijve	21
8. Mekanizmi i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave	25

Historiku

Procesi i liberalizimit të regjimit të vizave të Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit Perëndimor duhet kuptuar të ndërlidhur ngushtë me procesin e integritimit Evropian dhe axhendën evropiane që nënkupton ndërmarrjen e reformave të nevojshme politike, ekonomike e sociale nga vendet e Ballkanit Perëndimor në përputhje me standardet Evropiane.

Bashkimi Evropian në Samitin e Selanikut në Qershor 2003 ka konfirmuar perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe e ka ndërlidhur procesin e liberalizimit të vizave me progresin e arritur në ndërmarrjen e reformave në fushat që kanë të bëjnë me përfundimin e sundimit të ligjt, luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe migrimit ilegal dhe përfundimin e kapaciteteve administrative në kontrollin e kufijve dhe sigurinë e dokumenteve. Si rezultat i kësaj, Bashkimi Evropian në 2007 filloi negociatat me vendet e Ballkanit Perëndimor rreth ‘marrëveshjeve për lehtësim të vizave’ si hap të parë konkret drejt liberalizimit të plotë të regjimit të vizave. Edhe pse është konsideruar si instrument i suksesshëm, marrëveshjet për lehtësimin e vizave ka dështuar të sjellë ndryshime substanciale për përfaqësuesit e bizneseve, gazetarët, studentët, përfaqësuesit e shoqërisë civile, etj, të cilët kanë nevojë të udhëtojnë shumë shpesh në vendet e BE-së për shkak se procedurat e aplikimit janë të ndërlikuara dhe kërkojnë shumë kohë. Në këtë kontekst, paralelisht me hyrjen në fuqi të marrëveshjeve për lehtësim të vizave, në Pranverë 2008, Komisioni Evropian vendos të prezantoj ‘udhërrëfyesit’ për liberalizim të plotë të vizave me të gjitha vendet e rajonit, duke përjashtuar Kosovën. Udhërrëfyesit janë të kategorizuar në katër blloqe: 1. Siguria e dokumenteve, 2. Migrimi ilegal përfshirë ripranimin, 3. Rendi publik dhe siguria, dhe 4. Marrëdhëniet e jashtme dhe të drejtat fundamentale. Pas prezantimit të ‘udhërrëfyesve’ për këto vende nga Komisioni Evropian, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë hartuar raportet rreth gjendjes aktuale në fushat që i takojnë këtij procesi dhe ekspertët nga Komisioni Evropian dhe vendet anëtare të BE-së në kuadër të misioneve vlerësuese faktike në terren kanë hartuar raporte për secilin shtet të këtij rajoni rreth të arriturve në përmbushjen e obligimeve në kuadër të udhërrëfyesve.

Me 15 Korrik 2009, Komisioni Evropian i propozoi Këshillit të BE-së heqjen regjimit të vizave me Maqedoninë, Malin e Zi dhe Sërbinë, përderisa Shqipëria dhe Bosna e Hercegovina të mbeten nën regjimin e vizave, përderisa Kosova nuk është përfshirë fare këtë propozim. Debate të nxehta janë zhvilluar në Parlamentin Evropian rreth përfshirjes së Shqipërisë dhe Bosnës në listën e bardhë si dhe të ofrimit të një ‘udhërrëfyesi’ nga Komisioni Evropian për Kosovën duke mos gjykuar statusin politik të Kosovës. Argumente të shumta janë përdorur edhe nga OJQ-të, shoqëritë civile dhe intelektual të ndryshëm Evropian rreth përfshirjes së Shqipërisë, Bosnës dhe ofrimit të një perspektive të qartë për Kosovën si kushte themelore për stabilitet të tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor. Këshilli i BE-së pritet të votoj propozimin e Komisionit Evropian rreth heqjes së vizave për Maqedoninë,

Malin e Zi dhe Sërbinë, duke i mundësuar qytetarëve të këtyre vendeve të udhëtojnë në vendet e Bashkimit Evropian pa viza që nga 1 Janari 2010, përderisa për Shqipërinë dhe Bosnën dhe Hercegovinën, Komisioni Evropian do të vazhdoj të monitoroj zbatimin e masave dhe standardeve që rrjedhin nga udhërrëfyesit gjatë vitit 2010.

Duke pas parasysh vullnetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të mos mbetur prapa vendeve tjera të rajonit në ndërmarrjen e reformave të nevojshme në procesin e liberalizimit të vizave, nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme është hartuar 'Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me Komisionin Evropian', duke u bazuar në komponentet dhe fushat të cilat udhërrëfyesit e vendeve fqinjë i përmbajnë si dhe në praktikën e tyre. Ky udhërrëfyes është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 15 Maj 2009 dhe ka mandatuar Ministrinë e Punëve të Brendshme që të koordinoj aktivitetet rreth hartimit të Planit të Veprimit për implementimin e këtij udhërrëfyesi. Ky plan është hartuar me angazhimin e ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar dhe me angazhimin e institucioneve përgjegjëse për sektorët përkatëse. Plani i Veprimit për Liberalizimin e Vizave është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 15 Tetor 2009.

Ky hap i njëanshëm i Qeverisë së Republikës së Kosovës për të ndërmarrë reformat e nevojshme në procesin e liberalizimit të vizave dhe duke i konkretizuar ato në një plan qeveritar, tregon gatishmërinë dhe përkushtimin e Kosovës si një nga shtetet më të reja në rajon dhe në botë për të ndjekur shembujt dhe praktikën më të mira Evropiane dhe për të përmbushur të gjitha objektivat që Komisioni Evropian i ka vendosur për vendet tjera të rajonit dhe për të ecur në hapa të njëjta si vendet tjera të rajonit.

Plani i Veprimit për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian është hartuar duke pas parasysh gjendjen, zhvillimet dhe kapacitetet aktuale të administratës vendore dhe duke përqafuar qasjen reale në përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky dokument. Duhet theksuar që disa nga masat brenda këtij plani janë duke u zbatuar dhe për disa janë duke u marr hapa konkrete drejt finalizimit të tyre. Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që procesin e liberalizimit të vizave në kontekst të axhendës evropiane të vazhdoj ta konsideroj si prioritet dhe ti përmbush të gjitha obligimet që dalin nga Plani i Veprimit brenda kapaciteteve të saj.

Synimi i Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave

Plani i Veprimit përmbledh të gjitha objektivat e fushave të gjera, të përfshira në Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian. Ky plan përbëhet prej këtyre komponenteve:

- Siguria e dokumenteve / kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit;
- Bashkëpunimi në zbatimin e ligjit / parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, drogave, korrupsionit dhe trafikimit me qenie njerëzore;
- Bashkëpunimi gjyqësor në fushën e çështjeve penale;
- Politikat e azilit;
- Menaxhimi i migrimit;
- Menaxhimi i kufijve;
- Mbrojtja e të dhënave personale;
- Të drejtat e qytetarëve, përfshirë mbrojtjen e minoriteteve.

Në mënyrë që të plotësohen kriteret e lartpërmendura për liberalizimin e vizave me BE-në, institucionet e Republikës së Kosovës do të zbatojnë të gjitha masat e dhëna në vijim:

1. Siguria e dokumenteve / kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit

Masa 1.1. Themelimi i Agjencisë për Regjistrim Civil;

Masa 1.2. Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike për qytetarët e Republikës së Kosovës, në përputhje me kushtet e ICAO dhe Acquis të BE-së.

2. Bashkëpunimi agjencioneve në zbatimin e ligjit/parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar, terrorizmit, drogave, korrupsionit

Masa 2.1. Zbatimi i strategjisë kombëtare kundër krimit të organizuar dhe planit të saj të veprimit;

Masa 2.2. Miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;

Masa 2.3. Zbatimi i strategjisë kombëtare kundër drogave dhe planit të saj të veprimit;

Masa 2.4. Zbatimi i strategjisë kombëtare kundër terrorizmit dhe planit të saj të veprimit;

Masa 2.5. Zbatimi i strategjisë kombëtare kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe planit të saj të veprimit;

Masa 2.6. Themelimi i departamentit për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Politikave në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme;

Masa 2.7. Funkcionalizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të Departamentit për Siguri Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

3. Bashkëpunimi gjyqësor në fushën e çështjeve penale

Masa 3.1. Finalizimi i negociatave, nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet tjera relevante me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor në çështjet penale;

Masa 3.2. Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit për Çështje Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, me fokus tek Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor.

4. Politikat e azilit

Masa 4.1. Riorganizimi i Departamentit për Kufij, Azil dhe Migrim (DKAM) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM)

5. Menaxhimi i migrimit

Masa 5.1. Përforcimi i kapaciteteve menaxhuese në fushën e kontrollit të migrimit.

6. Menaxhimi i kufijve

Masa 6.1. Zbatimi i strategjisë kombëtare për menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Planit të saj të Veprimit.

7. Mbrojtja e të dhënave

Masa 7.1. Themelimi i sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale i Republikës së Kosovës.

8. Mekanizmi i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave

Masa 8.1. Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave dhe ndëlidhja e tij me strategjitë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit, kundër drogave, kundër korrupsionit, për parandalimin e krimit, për menaxhimin e integruar të kufijve, për migracion, për mbledhjen e armëve dhe planet e tyre të veprimit.

Plani i Veprimit

1. Siguria e dokumenteve/kushtet dhe procedurat për lëshimin e dokumenteve të identitetit

Masa 1.1		Themelimi i Agjencisë për Regjistrim Civil				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Hartimi i akteve nënligjore për punën e Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC)	Tetor 2009	MPB	MAPL, Komunitat	Kosto Administrative	
2	Miratimi i akteve nënligjore për punën e Agjencisë për Regjistrim Civil	Nëntor 2009	MPB		Kosto Administrative	
3	Përzgjedhja e Kryeshefit dhe Zv. Kryeshefit të ARC-së	Janar 2010	MPB		Kosto Administrative	
4	Hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të vendeve të punës	Mars 2010	MPB		Kosto Administrative	
5	Ristrukturimi i stafit në ARC	Maj 2010	MPB		20.000 €	
6	Hartimi dhe miratimi i planit të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për stafin e ARC-së	Qershor 2010	MPB		Kosto Administrative	
7	Organizimi i trajnimeve të nevojshme të specializuara për stafin e ARC-së	Në vazhdimësi	MPB		31.000 €	

Masa 1.2		Lëshimi i dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike për qytetarët e Republikës së Kosovës, në përputhje me kushtet e ICAO dhe Acquis të BE-së				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikiment Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Të kryhet studimi i fizibilitetit lidhur me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike për qytetarët e Republikës së Kosovës	Dhjetor 2009	MPB		200.000 €	
2.	Të zbatohen rekomandimet e studimit të fizibilitetit lidhur me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike për qytetarët e Republikës së Kosovës	Janar 2009	MPB		10.000.000 €	
3	Të organizohen trajnime për stafin përgjegjës për prodhimin e dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike	Prill 2010	MPB		20.000 €	
4	Të fillohet me lëshimin e dokumenteve të udhëtimit/pasaportave biometrike për qytetarët e Republikës së Kosovës	Qershor 2010	MPB		Kosto Administrative	
5	Të iniciohen marrëveshjet formale të punës me Interpol-in me qëllim të raportimit lidhur me pasaportat e humbura dhe të vjedhura	Qershor 2010	MPB	Policia e Kosovës		

2. Bashkëpunimi i agjencioneve në zbatimin e ligjit/parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, terrorizmit, drogave dhe korrupsionit

Masa 2.1.		Zbatimi i strategjisë kombëtare kundër krimit të organizuar dhe planit të saj të veprimit				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Miratimi i Projektligjit për Pengimin e Pastrimit të Parave	Tetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
2	Të themelohet Agjencioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar	Mars 2010	MD	Prokuroria e Shtetit	1.264.200 €	
3	Të hartohet Projektligji për Mbrojtjen e Dëshmitarëve	Nëntor 2009	MD	MPB MPJ	Kosto Administrative	
4	Miratimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve	Dhjetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
5	Miratimi i Projektligjit mbi plëtesimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës	Dhjetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
6	Miratimi i Projektligjit mbi plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës.	Dhjetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	

7	Të iniciohen negociatat për anëtarësimin e Njesisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës në Egmont Group të Njësive të Inteligjencës Financiare	Prill 2010	Qendra e Inteligjencës Financiare			
8	Të rritet numri i gjyqtarëve që mirren me rastet e krimit të organizuar dhe atij financiar	Dhjetor 2009	KGJK	Qeveria		
9	Të zbatohet pjesa e mbetur e aktiviteteve të strategjisë kombëtare kundër krimit të organizuar dhe planit të saj të veprimit	Në vazhdimësi	Në bazë të përgjegjësive të caktuara me Planin e Veprimit			

Masa 2.2		Miratimi dhe zbatimi i dokumenteve strategjike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Të miratohet Strategjia Anti-korrupsion për vitet 2009-2011 dhe Plani i saj i Veprimit	Dhjetor 2009	Kuvendi	MD AKK	Kosto Administrative	
2	Miratimi i Projektligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike	Janar 2010	Kuvendi		Kosto Administrative	
3	Miratimi i Projektligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë	Janar 2010	Kuvendi		Kosto Administrative	
4	Miratimi i plotësim/ndryshimit të Projektligjit për Luftimin e Korrupsionit	Janar 2010	Kuvendi		Kosto Administrative	
5	Vendosja e mekanizmave të bashkëpunimit në mes të Agjencisë Antikorrupsion, Prokurorisë së Shtetit dhe Gjykatave	Në vazhdimësi	Kuvendi	MD, AKK, KGJK, Prokuroria e Shtetit		

Masa 2.3.		Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Drogave dhe Planit të saj të Veprimit				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Fillimi i ndërtimit të Qendrës për Rehabilitim Social	Dhjetor 2011	MPMS	Komuna		1.000.000 €
2	Përpilimi i legjislacionit përcjellës lidhur me zvogëlimin e dëmeve shëndetësore dhe sociale që kanë të bëjnë me drogën	Dhjetor 2010	MSH		Kosto Administrative	
3	Miratimi i legjislacionit përcjellës lidhur me zvogëlimin e dëmeve shëndetësore dhe sociale që kanë të bëjnë me drogën	Dhjetor 2010	MSH		Kosto Administrative	
4	Plotësimi i numrit të personelit në kuadër të sektorëve për luftimin e drogave në Policinë e Kosovës	Dhjetor 2009	Policia e Kosovës		Kosto Administrative	
5	Plotësimi i numrit të personelit në kuadër të sektorëve për luftimin e drogave në Doganat e Kosovës	Dhjetor 2009	Doganat e Kosovës		Kosto Administrative	
6	Plotësimi i numrit të personelit në kuadër të sektorëve për luftimin e drogave në Shërbimin Korrektues	Dhjetor 2009	Shërbimi Korrektues		Kosto Administrative	
7	Aftësimi i personelit të policisë, shërbimit korrektues dhe doganave me trajnime të specializuara me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në luftimin drogave	Dhjetor 2011	Doganat e Kosovës	PK MD-SHKK	15.000 €	
8	Caktimi i prokurorëve përgjegjës për çështjet e drogave	Korrik 2010	Këshilli Prokurorial	MD	Kosto Administrative	
9	Të sigurohet trajnim i specializuar për prokurorët përgjegjës për çështjet e drogave	Dhjetor 2010	Këshilli Prokurorial	MD	Kosto Administrative	
10	Të zbatohet pjesa e mbetur e aktiviteteve të strategjisë kombëtare kundër drogave dhe planit të saj të veprimit	Në vazhdimësi	Në bazë të përgjegjësisë të caktuara me Planin e Veprimit			

Masa 2.4.		Zbatimi i Strategjisë Kombëtare kundër Terrorizimit dhe Planit të saj të Veprimit				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet perkrahese	Kostot Buxhetore	Asistenca e donatorëve
1	Hartimi i Projektligjit Kundër Terrorizmit	Nëntor 2009	ZKM	MPB, AIK, MD, FSK, MEF, MAPL, MASHT	Kosto Administrative	
2	Tw miratohet projektligji Kundër Terrorizmit	Dhjetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
3	Të miratohet projekt-ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik	Nëntor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
4	Të miratohet projektligji për Gjykatat	Dhjetor 2009	Kuvendi		Kosto Administrative	
5	Të miratohet projektligji për Prokuroritë Publike	Dhjetor 2009	Ministria e Drejtësisë	Këshilli i Prokurorisë së Kosovës	Kosto Administrative	
6	Tw miratohet projektligjit për Zyrën e Prokurorit të Shtetit nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Mars 2010	Kuvendi	MD, Këshilli i Prokurorisë së Kosovës	Kosto Administrative	
7	Hartimi i projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Kredibilitetit të të Dhënave	Nëntor 2009	ZKM	MPB, MTPT, MD, AIK, MFSK, MEF	Kosto Administrative	
8	Tw miratohet Projektligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Kredibilitetit të të Dhënave nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Dhjetor 2009	Qeveria e Republikës së Kosovës	MPB, MEF, MTPT, MASHT, AIK, MFSK	Kosto Administrative	

9	Të identifikohen rreziqet potenciale për Republikën e Kosovës nga aktet terroriste dhe të vlerësohet efekti i çfarëdo sulmi terrorist	Në vazhdimësi				
10	Të zbatohet pjesa e mbetur e aktiviteteve të strategjisë kombëtare kundër terrorizmit dhe plani i saj i veprimit	Afati kohor i Planit të Veprimit	Në pajtim me kompetencat e institucioneve të Republikës së Kosovës dhe përgjegjësitë e caktuara për to me Planin e Veprimit			

Masa 2.5.		Zbatimi i Strategjis Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Planit të saj të Veprimit				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Të sigurohet parandalimi i trafikimit dhe ri-trafikimit	Dhjetor 2011	MPB	Policia e Kosovës, MKRS, MAPL, MASHT, MTI, MPMS, Komunitat, ZKM, MSH, MD, Prokuroria e Kosovës, Prokuroria Speciale	Konform kostos te identifikuar ne strategjine anti trafikim.	
2	Të sigurohet mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve	Dhjetor 2011	MD, MPB	Prokuroria e Kosovës, Prokuroria Speciale, Gjykatat	Konform kostos te identifikuar ne strategjine anti trafikim.	
3	Të zhvillohen hetimet dhe të ndëshkohen të gjitha krimet e trafikimit	Dhjetor 2011	Prokuroria, Policia	MD, MPB, Gjykatat	Konform kostos te identifikuar ne strategjine anti trafikim.	

Masa 2.6		Themelimi i Departamentit për Hartimin , zbatimin dhe Monitorimin e Politikave brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Hartimi dhe miratimi i Udhëzimit Administrativ për strukturën e re organizative të MPB-së bazuar në rekomandimet e rishikimit funksional	Tetor 2009	MPB		Kosto Administrative	
2	Zhvillimi i termave të referencës për tre divizionet dhe përshkrimeve të vendeve të punës	Tetor 2009	MPB		Kosto Administrative	
3	Miratimi i strukturës organizative dhe përshkrimeve të vendeve të punës	Nëntor 2009	MPB		Kosto Administrative	
4	Rekrutimi i stafit (<i>vlerësimi i stafit aktual dhe rekrutimit të të tjerëve në bazë të strukturës së re</i>)	Dhjetor 2009	MPB		90.000 €	
5	Zhvillimi dhe miratimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit (<i>bazuar në përshkrimet e vendeve të punës dhe kapaciteteve të nevojshme në bazë të kompetencave të reja</i>)	Janar 2010	MPB		Kosto Administrative	
6	Organizimi i trajnimeve të nevojshme të specializuara për stafin e Departamentit	Shkurt 2010	MPB		12.000 €	
7	Rivlerësimi dhe përditësimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të Departamentit	Mars 2010	MPB		Kosto Administrative	

Masa 2.7.		Funksionalizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të Departamentit për Siguri Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Zhvillimi i termave të reja të referencës për divizionet dhe përshkrimeve të vendeve të punës	Shtator 2009	MPB		Kosto Administrative	
2	Miratimi i strukturës së re organizative dhe përshkrimeve të vendeve të punës	Shtator 2009	MPB		Kosto Administrative	
3	Rekrutimi i stafit (<i>vlerësimi i stafit aktual dhe rekrutimit të tjerëve në bazë të strukturës së re</i>)	Dhjetor 2009	MPB		84.000 €	
4	Zhvillimi dhe miratimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit (<i>bazuar në përshkrimet e vendeve të punës dhe kapaciteteve të nevojshme në bazë të kompetencave të reja</i>)	Dhjetor 2010	MPB		Kosto Administrative	UNDP-KOSSAC EC - TAIEK
5	Organizimi i trajnimeve të specializuara dhe të domosdoshme për stafin e Departamentit	Në vazhdimësi	MPB	AKZHIE	20.000 €	
6	Rivlerësimi dhe përditësimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit Departamentit	Mars 2010	MPB		Kosto Administrative	
7	Kompletimi i kornizës ligjore me akte ligjore dhe nënligjore	Shtator 2010	MPB	ZKM, MEF, MFSK, MMPH, Policia e Kosovës	Kosto Administrative	

3. Bashkëpunimi gjyqësor në fushën e çështjeve penale

Masa 3.1		Finalizimi i negociatave, nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjeve bilaterale me shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e tjera relevante me qëllim të bashkëpunimit ndërkombëtar gjyqësor në çështjet penale				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Austrisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
2	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet lidhur me transferimin e të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shqipërisë, Maqedonisë dhe Serbisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
3	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Danimarkës	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
4	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Belgjikës.	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
5	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Zvicrës	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
6	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Gjermanisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
7	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarave ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Finlandës, Norvegjisë dhe Suedisë.	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	

8	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Francës	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
9	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Italisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
10	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Turqisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	
11	Të kryhen negociatat dhe të nënshkruhen marrëveshjet e transferimit të pandehurve dhe të dënuarve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Sllovenisë	Dhjetor 2010	MD	MPJ	Kosto Administrative	

Masa 3.2		Përmirësimi i kapaciteteve të Departamentit për Çështje Ligjore të Ministrisë së Drejtësisë, me fokus tek Divizioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar Ligjor.				
Aktivitetet	Afati Kohor			Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	
1	Rekrutimi i stafit shtesë të 12 Zyrtarëve të Lartë Ligjorë, Asistentëve Administrativë dhe Themelimi i Njësisë së Përkthimit.	Mars 2010	MD	MEF	120.000 €	
2	Hartimi dhe miratimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Divizionit për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar <i>(bazuar në përshkrimet e vendeve të punës dhe kapaciteteve të nevojshme në bazë të kompetencave të reja)</i>	Dhjetor 2009	MD		Kosto Administrative	
3	Rivlerësimi dhe përditësimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Divizionit për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar	Dhjetor 2009	MD		Kosto Administrative	

4. Politikat e azilit

Masa 4.1.		Riorganizimi i Departamentit për Kufij, Azil dhe Migrim (DKAM) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DSHAM)				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Hartimi i plotësim ndryshimit të Udhëzimit Administrativ të MPB nr. 2008/01 për Strukturimin dhe Organizimin e Brendshëm të MPB-së	Shtator 2009	MPB		Kosto Administrative	
2	Funksionalizimi i Qendrës së ardhshme të Pranimi për Azilkërkues	Mars 2010	MPB		300.000 €	
3	Vendosja e Zyrës për Shtetësi nën vartësinë e DSHAM	Tetor 2009	MPB		Kosto Administrative	
4	Hartimi i termave të referencës për katër divizionet dhe qendrën e pranimi si dhe të përshkrimeve të vendeve të punës.	Nëntor 2009	MPB		Kosto Administrative	
5	Miratimi i strukturës organizative dhe përshkrimeve të vendeve të punës	Nëntor 2009	MPB		Kosto Administrative	
6	Rekrutimi i stafit (<i>vlerësimi i stafit aktual dhe rekrutimit të tjerëve në bazë të strukturës së re</i>)	Janar 2010	MPB		40.000 €	
7	Hartimi dhe miratimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit. (<i>bazuar në përshkrimet e vendeve të punës dhe kapaciteteve të nevojshme në bazë të kompetencave të reja</i>)	Shkurt 2010	MPB-		Kosto Administrative	
8	Rivlerësimi dhe azhurimi i planit të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të stafit të Departamentit	Mars 2010	MPB		Kosto Administrative	

5. Menaxhimi i migrimit

Masa 5.1.		Përforcimi i kapacitetit menaxhuese në fushën e kontrollit të migrimit				
Aktivitetet		Afati kohor	Njësia përgjegjëse	Institucionet perkrahese	Kostot Buxhetore	Asistenca e donatorëve
1	Hartimi i Udhëzimeve Administrative në mënyrë që të qartësohen kompetencat ndërmjet Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion dhe DMH-s – Policia Kufitare në fushën e migracionit	Tetor 2009	MPB	Policia e Kosovës	Kosto Administrative	
2	Miratimi i Udhëzimeve Administrative të përmendura në veprimin nr.1	Nëntor 2009	MPB		Kosto Administrative	
3	Të trajnohet stafi i DSHAM dhe i DMH-PK përgjegjës për çështjet e vizave dhe lejeve të qëndrimit	Në vazhdimësi	MPB	MPJ, Policia e Kosovës		
4	Krijimi i bazës kombëtare të të dhënave mbi lëshimin e vizave	Maj 2010	MPB	MPJ	500.000 €	
5	Të miratohet kodi specifik uniform i etikës lidhur me antikorrupsionin për zyrtarët e MPB-së dhe MPJ-së që merren me lëshimin e vizave dhe lejeve të qëndrimit	Janar 2010	MPB	MPJ	Kosto Administrative	
6	Të trajnohet stafi i konsullatave të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me lëshimin e vizave	Tetor 2009	MPJ	MPB		
7	Të hartohet dokumenti i politikave të vizave dhe të dorëzohet te Qeveria e Republikës së Kosovës	Tetor 2010	MPJ	MPB	Kosto Administrative	

8	Të miratohet dokumenti i politikave të vizave nga Qeveria e Republikës së Kosovës	Dhjetor 2010	Qeveria		Kosto Administrative	
9	Të themelohen misione diplomatike të Republikës së Kosovës	Në vazhdimësi	Presidenti i Republikës së Kosovës	MPJ		
10	Të themelohen misionet konsullore të Republikës së Kosovës	Në vazhdimësi	Presidenti i Republikës së Kosovës	MPJ		
11	Të plotësohen misionet konsullore me stafin e nevojshëm.	Në vazhdimësi	MPJ			
12	Të nënshkruhet marrëveshja e ripranimit me Shqipërinë	Tetor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
13	Të nënshkruhet marrëveshja e ripranimit me Belgjikën	Nëntor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
14	Të nënshkruhet marrëveshja e ripranimit me Gjermaninë	Nëntor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
15	Të nënshkruhet marrëveshja e ripranimit me Norvegjinë	Nëntor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
16	Të nënshkruhet marrëveshja e ripranimit me Zvicrën	Nëntor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
17	Të nisnin negociatat për ripranim me së paku 5 Shtetet Anëtare të BE-së	Dhjetor 2009	MPB	MPJ, MAPL, MPMS, PK	Kosto Administrative	
18	Themelimi i databazës për monitorimin e vëllimit të migracionit	Nëntor 2009	MPB	Policia e Kosovës, MPJ	Kosto Administrative	

6. Menaxhimi i kufijve

Masa 6.1		Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Planit të Veprimit				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Shtirirja e internetit në të gjitha pikat kufitare	Dhjetor 2009	Policia e Kosovës	MPB, Doganat, AVUK		IPA 2007
2	Instalimi i sistemit të integruar të TI-së në vendkalimet kufitare	Maj 2010	Policia e Kosovës	MPB	1.600.000 €	
3	Përmirësimi i infrastrukturës së përshtatshme në vendkalimet kufitare	Në vazhdimësi	Policia e Kosovës	MPB	1.000.000 €	
4	Ofrimi i pajisjeve të nevojshme për Policinë Kufitare: 1. Vlerësimi i nevojave për pajisje shtesë 2. Zhvillimi i planit të investimeve 3. Blerja dhe instalimi/funksionalizimi	Maj 2011	Policia e Kosovës	MPB	300.000 €	
5	Të ngriten e kapacitetet e Policisë Kufitare përmes trajnimeve të avancuar	Në vazhdimësi	Policia e Kosovës		50.000 €	
6	Të iniciohet dialogu i bashkëpunimit me Frontex	Nëntor 2009	Policia e Kosovës	MPB, MPJ		Projekt i binjakëzimit
7	Të freskohet plani i veprimit për zbatimin e strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve	Janar 2010	Policia e Kosovës	Doganat e Kosovës, AVUK, MPB		

8	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Shqipërisë	Tetor 2009	Doganat e Kosovës	MPJ		
9	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Bullgarisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	2.000 €	
10	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Kanadasë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	
11	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Kroacisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	6.000 €	
12	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Republikës Çeke	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
13	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Finlandës	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	
14	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Francës	Nëntor 2009	Doganat e Kosovës	MPJ	1.000 €	
15	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Gjermanisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	2.000 €	
16	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Hungarisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
17	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Irlandës	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	

18	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Italisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	
19	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Maqedonisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
20	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Malit të Zi	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	2.000 €	
21	To Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Norvegjisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	2.000 €	
22	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Polonisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
23	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Sllovenisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	
24	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Suedisë	Dhjetor 2010	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
25	Të nënshkruhet marrëveshja për asistencë të ndërsjellë me autoritetet e Turqisë	Tetor 2009	Doganat e Kosovës	MPJ	5.000 €	
26	Të iniciohen propozime tjera për marrëveshje bilaterale me administratat doganore të vendeve tjera	Në vazhdimësi	Doganat e Kosovës	MPJ	4.000 €	
27	Të iniciohet kërkesa nga Dogana e Kosovës për anëtarësim në Organizatën Botërore të Doganave (OBD)	Prill 2010	Doganat e Kosovës	MPJ		

7. Mbrojtja e të dhënave

Masa 7.1		Themelimi i sistemit për mbrojtjen e të dhënave personale i Republikës së Kosovës				
Aktivitetet		Afati Kohor	Institucioni Përgjegjës	Institucionet Përkrahëse	Implikimet Buxhetore	Asistenca e Donatorëve
1	Miratimi i Projekt-Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Janar 2010	Kuvendi		Kosto Administrative	
2	Propozim-vendimi i Qeverisë për emërimin e Këshillit Mbikëqyrës për Mbrojtjen e të Dhënave	Shkurt 2010	Qeveria		Kosto Administrative	
3	Themelimi i Agjencisë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Prill 2010	Kuvendi	Qeveria	163.420 €	
4	Hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të vendeve të punës	Prill 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave		Kosto Administrative	
5	Të elaborohet kodi uniform i etikës lidhur me antikorrupsionin për zyrtarët e Agjencisë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Prill 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave			
6	Të miratohet kodi uniform i etikës lidhur me antikorrupsionin për zyrtarët e Agjencisë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Maj 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave		Kosto Administrative	
7	Rekrutimi i stafit për Agjencinë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Maj 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave			

			Dhënave			
8	Zhvillimi dhe miratimi i planit për ngritjen e kapaciteteve të stafit për Agjencinë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Korrik 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave			
9	Organizimi i trajnimeve të domosdoshme të specializuara për stafin e Agjencisë Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave	Korrik 2010	Agjencia Mbikëqyrëse për Mbrojtjen e të Dhënave			

8. Mekanizmi i monitorimit për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave

Masa 8.1.		Të monitorohet zbatimi i Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave dhe të sigurohet lidhja e tij me strategjitë për luftimin e trafikimit me qenie njerëzore, kundër krimit të organizuar, kundër terrorizmit, kundër drogave, kundër korrupsionit, për parandalimin edhe reduktimin e krimit, për menaxhimin e integruar të kufijve, për Migracionin për mbledhjen e armeve dhe planet e tyre të veprimit.				
Aktivitetet		Afati kohor	Institucionet përgjegjëse	Institucionet përkatëse	Kostot Buxhetore	Asistenca e donatorëve
1	Të themelohet Grupi Punues për Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave.	Shtator 2009	Qeveria	MPB	Kosto Administrative	
2	Të themelohet Sekretaria e Grupit Punues për Elaborimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave	Shtator 2009	MPB		Kosto Administrative	
3	Ti ofrohen informatat Sekretariatit të lartpërmendur lidhur me progresin e zbatimit të strategjisë kombëtare dhe planeve të veprimit	Në baza mujore	GP për Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit për		Kosto Administrative	

			Liberalizimin e Vizave			
4	T'i dorëzohen Qeverisë raportet mujore për zbatimin e Planit të Veprimit për Liberalizimin e Vizave.	Në vazhdimësi	MPB	MPJ, MD, MEF, MAPL, MPMS, MKK, MSH, MAP, Policia, Doganat, Shërbimi Korrektues	Kosto Administrative	
5	Të sigurohet reflektimi i masave/veprimeve të këtij Planit Veprimi në procesin e hartimit të strategjive të rregullta legjislative (Buxheti Vjetor dhe KASHI).	Në vazhdimësi	MPB	ZKM Kuvendi	Kosto Administrative	
6	Të sigurohet reflektimi i masave/veprimeve të këtij Planit Veprimi në procesin e rregullt të buxhetimit (Buxheti Vjetor dhe KASHI).	Në vazhdimësi	MPB	MEF	Kosto Administrative	
7	Të sigurohet reflektimi i sfidave të dokumenteve relevante të Komisionit Evropian (në veçanti Raportit të rregullt të Progresit) gjatë rishikimit të këtij Planit të Veprimit.	Në vazhdimësi	Sekretariati i GP	AKZhIE	Kosto Administrative	
8	Të sigurohet reflektimi adekuat i këtij Planit të Veprimit në rishikimin e rregullt të Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE).	Në vazhdimësi	Sekretariati i GP	AKZhIE	Kosto Administrative	
9	Të sigurohet reflektimi adekuat i këtij Planit të Veprimit në hartimin e dokumenteve të asistencës së BE-së (IPA, TAIEX, Twinning).	Në vazhdimësi	Sekretariati i GP	AKZhIE	Kosto Administrative	
10	Të raportohet rregullisht progresi, si dhe të diskutohen sfidat e mundshme (sidomos ato që kanë të bëjnë me bashkëpunimin ndër-institucional) në zbatimin e këtij Planit të Veprimit në strukturat institucionale për Integrim Evropian (GP "Qeverisja", Komiteti Punues për IE dhe Këshilli Ministror për IE)	Në vazhdimësi	Sekretariati i GP	AKZhIE	Kosto Administrative	